

Programi Hubert H. Humphrey

Programi Hubert H. Humphrey dërgon në Shtetet e Bashkuara profesionistë që janë në mes të karrierës së tyre profesionale dhe me potencial udhëheqës, për një program dhjetë mujor, të nivelit pasuniversitar, me kurse akademike dhe aktivitete të zhvillimit profesional por që nuk përfundon me diplomë. Duke iu ofruar udhëheqësve të ardhshëm dhe hartuesve të politikave një përvojë në shoqërinë dhe kulturën amerikane, si edhe fushat profesionale, programi siguron një bazë të qëndrueshme për lidhje të frytshme mes amerikanëve dhe homologëve të tyre profesionistë jashtë shtetit. Kandidatët nominohen në bazë të potencialit për udhëheqje dhe përkushtim në shërbim publik.

Kriteret e Përzgjedhjes:

- ✓ Aplikantët duhet të jenë qytetarë të Republikës së Shqipërisë
- ✓ Aplikantët duhet të kenë të paktën një diplomë të nivelit Bachelor nga një program studimi me kohë të plotë katër vjeçar (ose diplomë te programeve tre + një ose tre + dy sipas Sistemit të Bolonjës).
- ✓ Aplikantët duhet të jenë të punësuar në Shqipëri
- ✓ Aplikantët duhet të kenë të paktën pesë vjet përvojë profesionale pune në fushën e studimit
- ✓ Aplikantët duhet të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2; Përfshini rezultatet e provimit të TOEFL ose IELTS nëse janë të vlefshme)
- ✓ Aplikantët duhet të demonstrojnë aftësi lidhësi dhe përkushtim në shërbimin publik
- ✓ Aplikantët duhet të kualifikohen për të marrë vizë J-1.
- ✓ Aplikantët duhet të kenë rekorde të mira shëndetësore.

Thirrja për vitin akademik 2023-2024 hapet shpejt.

Per me shume informacion, te interesuarit mund te klikojne ne <https://al.usembassy.gov/education-culture/educational-exchange-programs/fulbright-programs/>

Per pyetje te tjera mund te kontaktojne edhe ne kete adrese email:
CultureandEducationTirana@state.gov